



Ministria e Puneve te Jashtme



Ministria e Ekonomise, Tregtise & Energjitikes

Zyra e Bashkepunimit per Zhvillim E Ministrise se Jashtme Italiane

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes e Qeverise Shqiptare

Programi per Zhvillimin e Ndermarrjeve te Vogla dhe te Mesme.

Prezantimi

Qeveria Italiane dhe Qeveria Shqiptare kane firmosur nje marreveshje per realizimin e nje Programi per zhvillimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme shqiptare (NVM).

Programi i financuar nga Qeveria Italiane, perfshin tre komponente te rendesishem:

- 25 milion Euro kredi e bute, qe perben fondin per [Linjen e Kredise](#) ne favor te NVM-ve
- 2.5 milion Euro kredi e bute per krijimin e [Fondit te Garancise](#), i cili mbeshtet NVM Shqiptare te kene nje mundesi me te madhe per te marre kredi
- 1,7 milion Euro dhurate per [Asistencen Teknike](#) ne funksion te realizimit te Programit.

Kjo inisiativë, ka si qëllim të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, lehtësimin e sistemit të kreditimit të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, duke favorizuar ekonomine formale.

“Komiteti Drejtues i Linjes se Kredise” (CLSC) i Programit i perbere nga Ministria e Ekonomise, Ministria Finances, Banka e Shqiperise

dhe nga Ministria e Puneve te Jashtme Italiane ka aprovuar ne Tetor 2008 procedurat e funksionimit te Programit, te cilat perfshijne kushtet per te perfituar nga Linja e Kredise.

Procedurat dhe Kushtet e Linjes se Kredise

Kriteret e pranimit per Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme:

Mund te perfitojne nga kjo linje kredie te gjitha NVM qe plotesojne kriteret e meposhtme:

- Shoqeria eshte e rregjistruar ne Shqiperi
- Jo me pak se 51% e kapitalit themeltar te shoqerise zoterohet nga shtetas shqiptar.
- Shoqeria ka nje xhiro vjetore jo me te larte se 5 milion Euro.
- Shoqeria ka nje numer punonjesish jo me shume se 80-te.

Projektet e NVM-ve te pranueshme per tu financuar nga kjo Linje Kredie jane:

- Projekte te cilat kane nje limit te kredise se kerkuar nga 50.000,00 Euro deri ne 500.000,00 Euro
- Jo me pak se 70% e vleres se financuar te projektit duhet te perdoret per blerjen e lendes se pare, pajisjeve, teknologjise, asistences teknike, perfshire trainime, mirembjatje, pjese kembimi dhe license industriale me origjine Italiane, te gjitha keto te furnizuara nga prodhues Italiane.
- Jo me shume se 30% e financimit te kerkuar per cdo projekt te vetem, mund te perdoret per mbulimin e kostove lokale te ketij projekti.

Nuk jane te financueshme nga Linja e Kreditit:

- Taksa lokale, taksa doganore, TVSH;
- Kapitali qarkullues (duke perjashtuar shumen fillestare qe nevojitej per celjen e aktivitetit te nisur rishtasi (start-up)
- Joint Venture, ndermarrjet tregtare dhe financiare te perkoheshme;
- Investime ne sektorin e kohes se lire, pasuri te patundshme, armatime, droga dhe alkoolike, duhan dhe derivatet e tij,

prodhimi i produkteve te ndaluara per importim dhe eksportim nga vendet BE, ne baze te marreveshjeve nderkombetare

Kushtet per dhenien e kredise

Norma e interesit qe aplikohet:

- maksimumi 5.5% interes vjetor per kredite ne Euro
- maksimumi 8.5% interes vjetor per kredite ne Lek

Periudha e shlyerjes se kredise: nga 3-8 vjet.

Periudha e mospagimit(paguhet vetem interesi): Nga 1-2 vjet.

Prioritetet dhe kushtet me te favorshme.

<p>Jane konsideruar si prioritare:</p> <ul style="list-style-type: none">- NVM prodhuese- NVM eksportuese (eksport i te pakten 50% te totalit te shitjeve)- NVM te themeluara rishtasi, nga nenshtetas shqiptare rezident ne Itali.- NVM te perqendruara ne zona/parqe industriale te vendit. <p>Projekte/Spektori:</p> <ul style="list-style-type: none">- Spektori i agrokultures dhe agroushqimor- Projekte per prodhimin natyror te energjise ose projekte per eficencen/ruajtjen e energjise.- Projekte me impakt te ulet ambiental ose qe ulin ndotjen e mjedisit.- Projekte qe krijojne vende te reja pune. <p>Projekte te lokalizuara ne zonat me pak te zhvilluara te vendit (jashte zones Tirane-Durre).</p>	<p>Kushtet me te favorshme.</p> <ul style="list-style-type: none">- Projektet prioritare me nje vlere qe varion nga 50.000,00 ne 150.000,00 Euro perfitojne automatikisht nje periudhe te shlyerjes per 5 vjet, perfshire dhe periudhen 2 vjet te mospagimit (paguhet vetem interesi).- Projektet prioritare me nje vlere qe varion nga 150.001,00 ne 500.000,00 Euro perfitojne automatikisht nje periudhe te shlyerjes per 8 vjet, perfshire dhe periudhen 2 vjet te mospagimit (paguhet vetem interesi).
--	--

Financimi i Projekteve te Vogla

Jo me shume se 10% e shumes totale te Linjes se Kreditit mund te perdoret per te financuar projekte te celura rishtasi (“start up”), me nejt vlere qe varion nga 15.000,00 deri ne 50.000,00 Euro.

- Keto projekte perfshihen ne nje periudhe ripagimi prej 4 vjetesh, duke perfshire 2 vjete mospagim perfitojne automatikisht nje periudhe te ripagimit per 5 vjet, perfshire dhe periudhen 2 vjet te mospagimit (paguhet vetem interesi).

Procedurat per te perfituar Linjen e Kredise

NVM-te e interesuara per te perfituar nga Linja e Kredise duhet t’i drejtohen Bankave Tregtare Private qe jane te perfshira ne Program. Cdo Banke Tregtare Private do te kerkoje nga NVM-ja aplikante, dokumentacionin e nevojshem per kerkesen e financimit, dhe pas shqyrtimit te kerkeses do te firmose kontratat e huase me NVM-te per projektet e aprovuara.

Bankat Tregtare Private jane pergjegjese per aprovimin ose mosaprovimin e Linjes se Kredise se kerkuar nga NVM-te.

Gjate vleresimit te kerkeses se NVM-ve, Bankat Tregtare Private do te kene ne konsiderate kushtet e percaktuara nga Programi.

“Njesia e Manaxhimit te Programit” (PMU), e krijuar nga Ministria e Ekonomise me eksperte Shqiptare dhe Italiane, do te monitoroje te gjitha aktivitetet e zhvilluara ne menyre qe te verifikoje respektimin e procedurave dhe te kushteve te percaktuara nga CLSC.

Kontaktet

Njesia e Manaxhimit te Programit (PMU)

Godina e METE’s

Bulevardi “Zhan D’Ark”, No. 2 – Kati 5

Tirana

Tel: +355 4 2366811

Tel/Fax: +355 4 2366449
Email: pmu@mete.gov.al

Per informacion te metejshe me lidhje me Bankat Tregtare Private
qe do te operojne me programin, Ju lutemi kontaktoni me zyrat e
PMU-s.